



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT
O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) më datën 17.05.2016 realizoi vizitë të jashtëzakonshme në Qendrën për pranimin e azilkërkuesve në Vizbeg, në suaza të mandatit dhe kompetencave konform Protokollit Fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues dhe Ligjit të Avokatit të Popullit.

Kjo ishte vizita e katërt nga ana e ekipit të MPN-së, pas vizitave të kryera më datë 14.12.2011, 20.03.2013 dhe 23.06.2015.

Qëllimi i vizitës ishte të kontrollohen dhe monitorohen kushtet dhe trajtimi i personave azilkërkues në kulmin e krizës së refugjatëve, të konstatohet situata momentale dhe numri i kapaciteteve për akomodim dhe numri i personave të strehuar për momentin, kërkues të së drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë vizitës ekipi i MPN-së bisedoi me personat udhëheqës dhe përgjegjës në Qendrën për azilkërkues, vizitoi rreth e përqark tre ndërtesat e Qendrës prej të cilave e para është ndërtesë administrative, ndërsa dy të tjerat janë ndërtesa me kapacitete akomoduese, ndërkaq bisedoi edhe me disa migrantë procedurat e të cilëve për fitimin e të drejtës për azil janë në vazhdim e sipër dhe janë ende në pritje.

Gjithashtu u bë inspektim edhe në kuzhinë, ambientin për edukim, çerdhen, Seksionin ambulancor, ambientet ku janë vendosur azilkërkuesit si dhe në ambientin e deposë.

Gjatë vizitës në suaza të Qendrës, ekipi i MPN-së konstatoi se Qendra e azilkërkuesve shfrytëzon vetëm ndërtesën e parë ku ka dhoma për strehim, ndërsa ndërtesa e dytë është në proces të rinovimit ku është duke u sanuar fasada. Numri aktual i azilkërkuesve është 52 persona, prej të cilëve 21 burrë, 11 gra dhe 20 fëmijë. Kapaciteti i akomodimit në Qendër është parashikuar për 150 persona, kështu që gjatë kohës së vizitës nuk kishte asnjë problem nga afër për mbipopullim të mundshëm në Qendër.

Sa i përket kujdesit shëndetësor dhe medicinal i cili u mundësohet azilkërkuesve, u bisedua edhe me mjekun për mjekësi të përgjithshme i cili u gjet në vendin e tij të punës, ndërkaq i cili informoi se është angazhuar të mbron shëndetin dhe të jep shërbime nga mjekësia e përgjithshme, dy here gjatë javës nga 2,3 orë në ditë, me mundësi që, në qoftë se paraqitet nevoja për të qenë edhe më tutje në vendin e punës, të mbetet konform nevojave.

Disa migrantë të vendosur në Qendrën për azilkërkues u ankuan lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit dhe shujtat të cilat i pranojnë gjatë qëndrimit të tyre. Gjegjesisht, ushqimi dërgohet nga kompania private „Uni Merkant” në bazë të marrëveshjes së lidhur me Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale si ministri kompetente dhe përgjegjëse për menaxhim me Qendrën e azilkërkuesve dhe sipas të njëjtës kompania private është obliguar të sigurojë dhe furnizojë ushqim për Qendrën, të llojit të këteringut. Përveç ushqimit të parashikuar i cili ndahet dy here në ditë, përmes Organizatës ndërkombëtare JRS, migrantëve u ndahen edhe pako me kroasanë, produkte qumshti dhe ushim tjetër-shtesë.

Megjithatë, migrantët njoftuan se janë të pakënaqur nga cilësia e ushqimit të cilin e pranojnë duke vënë në dukje se i njëjti nuk ka shije dhe nuk u pëlqen. Përmendën se nuk janë të kënaqur edhe me sasinë e ushqimit, përkatësisht nga sasia të cilën e pranojnë dhe e cila nuk është e mjaftueshme për një vakët.

Sa i përket pakos së parashikuar mujore, që përmban mjetet për higjienë personale, theksuan se e njëjta nuk i plotësojnë nevojat elementare dhe se nuk janë të mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat personale për muajin rrjedhës.

Si në vizitat e mëparshme edhe gjatë kësaj vizite, ekipi i MPN-së konstatoi se ambientet në të cilat janë vendosur azilkërkuesit janë në gjendje të duhur, tualetët janë të pastër, shtrettrat nëpër dhoma rregullisht ndërohen, gjithashtu azilkërkuesit kanë në dispozicion makinë për larje të rrobave dhe makinë për tharje të rrobave.

Mbetet e pandryshueshme përshtypja se Qendra përmbush standardet bazë dhe kriteret minimale për akomodimin e azilkërkuesve në këtë institucion.